


Врз основа на член 55 став 1 од Законот за организација и работа на органите на државната управа („Службен весник на Република Македонија” бр. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10, 51/11 и „Службен весник на Република Северна Македонија“ 96/19 и 110/19), како и врз основа на член 50 став 6 од Законот за основно образование („Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 161/2019) министерот за образование и наука донесе скратена наставна програма по наставниот предмет *албански јазик* за V одделение на деветгодишното основно образование за учебната 2020/21 година.

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11), dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” 96/19 dhe 110/19) si dhe në bazë të nenit 50 alinea 6 të Ligjit për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 161/2019) ministrii Arsimit dhe Shkencës e solli programine shkurtuar për lëndën e *gjuhës shqipe* për klasën V (pestë) të arsimit fillor nëntëvjeçar. për vitin shkollor 2020/2021.

PROGRAMI ARSIMOR I SHKURTUAR



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Gjuhë shqipe

KLASA E PESTË

2020

ARSIMI FILLOR NËNTËVJEÇAR

1. Hyrje

Programi i shkurtuar arsimor nga lënda Gjuhë shqipe themelohet në qëllimet / në rezultatet e pritura të parapara me Programin arsimor të lëndës mësimore që realizohet rregullisht në pajtim me planin e vërtetuar arsimor.

Me programin e shkurtuar mësimor përcaktohen fusha dhe përmbajtje mësimore të caktuara që duhet të realizohen për 159 ditë mësim duke e respektuar fondin javor të orëve të paraparë në programin e rregullt, 5 orë në javë respektivisht 159 orë.

Arsimtari gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga Programi mësimor i shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet/rezultatet e pritura, nocionet e caktuara, metodat dhe aktivitetet e përcaktuara në programin e mësimimit të rregullt.

Numri rendor	FUSHAT PROGRAMORE	
1.	NJOHURI PËR GJUHËN	42
2.	DREJTSHKRIMI DHE DREJTSHQIPTIMI	10
3.	LEXIMI, LETËRSIA DHE LEKTYRA	67
4.	TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIJA	30
5.	5. FUSHA PROGRAMORE: KULTURA E MEDIËS	10
	Gjithsej	159

2. Fushat programore dhe përmbajtjet mësimore

1. FUSHA PROGRAMORE:NJOHURI PËR GJUHËN (42)

Përmbajtjet mësimore:

1. Gjuha si mjet komunikimi
2. Të dallojë llojet e letrave si mjete komunikimi
3. Fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme
4. Të tregojë me se shprehen pjesët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme në fjali.
5. Emrat e përveçëm dhe të përgjithshëm
6. Në tekstin “ Sytë e shkollës” klasifikim i emrave të përgjithshëm dhe të përveçëm në kolona të veçanta!
7. Emrat konkretë dhe abstraktë
8. Ushtrime – emrat konkretë dhe abstraktë
9. Rasat e emrit
10. Lakimi i emrit
11. Lakimi i emrit (ushtrime)
12. Mbiemrat cilësor dhe marëdhënior
13. Ti dallojë mbiemrat cilësor në tekst
14. Gjuhë: Përemrat vetorë
15. Ushtrime: Përemrat vetorë .
16. Përemrat pyetës *kush? Cili?*
17. Përsëritje për përemrat
18. Kontrollimi i njohurive
19. Folja, kuptimi mbi të
20. Ushtrime, përdorimi i fojes
21. Fjalía e thjeshtë
22. Fjalía e përbërë
23. Përsëritje tematike
24. Sinonomet, antonimet, homonimet
25. Ushtrime: Sinonomet, antonimet, homonimet
26. Gjuhë: fjalët me kuptim zvogëlues dhe përkëdhelës

27. Ushtrime:Gjeni dhe shkruani fjalë me prapashtesat ush, ushkë, z
28. Gjuhë: Ligjerata e drejtë dhe e zhdrejtë
29. Gjuhë: Pikësimi në ligjeratën e drejtë dhe të zhdrejtë
30. Lexojmë tekstin dhe i vëm shenjat..
31. Gjuhë: Shenjat e pikësimit
32. Gjuhë:Përdorimi i pikës
33. Ushtrime: Tekst përdorimi i pikes
34. Gjuhë:Pikëpyetja dhe pikëçuditja
35. Ushtrime :tekst me përdorim të pikëçuditjes
36. Gjuhë:Përdorimi i presjes
37. Ushtrime në tekst: Gjuhë:Përdorimi i presjes
38. Gjuhë:Përdorimi i drejtë i shkurtesave
39. Ushtrime me shkrim : Përdorimi i drejtë i shkurtesave
40. Gjuhë:Përdorimi i shkronjës së madhe
41. Ushtrime : Përdorimi i shkronjës së madhe
42. Teksti: “Në kurs të gjuhës”

2. FUSHA PROGRAMORE: DREJTSHKRIMI DHE DREJTSHQIPTIMI (10)

Përmbajtjet mësimore:

1. Shkrimi I emrave të përveçëm
2. Përdorimi i kryerreshtit
3. Shkrimi i i emrave femrorë që mbarojnë me “ë”
4. Shkrimi dhe drejtshqiptimi i mbiemrave të gjinisë mashkullore dhe femërore
5. Shkrimi I numrave me fjalë
6. Kopjimi i teksteve
7. Diktimi

8. Drejtshqiptimi i tingujve y dhe i
9. Drejtpërdorimi I tingujve: ç, dh,ë, gj, nj, q, rr,s,sh,th,z, xh
10. Drejtpërdorimi i tingujve r dhe rr I dhe ll

3. FUSHA PROGRAMORE:LEXIMI, LETËRSIA DHE LEKTYRA (67)

Përmbajtjet mësimore:

1. Bisedë: Pushimet verore
2. Teksti: “ Sytë e shkollës” (ose sipas zgjedhjes të arsimtarit)
3. Analiza e tekstit :“ Sytë e shkollës”
4. Poezia: “Ti shkollë”
5. Tabloja poetike e poezisë – përshkrimi
6. Teksti “Mësuesi i sëmurë”
7. Bisedë rreth tekstit: (ose sipas zgjedhjes të arsimtarit)
8. Poezia “Mëmëdheu”
9. Ushtrime për analizë tematike – ideore të poezisë
10. Ritregojmë një ngjarje
11. Përpunimi i lektyrës :
12. Vazhdimi i lektyrës
13. Zhvillim poezia: “Fjalët e qiririt”
14. Analizë e poezisë dhe recitim
15. Teksti: “Plaku zemërbardhë” (ose sipas zgjedhjes të arsimtarit)
16. Analizë e tekstit
17. Teksti: “I pasuri dhe i varfëri” (ose sipas zgjedhjes të arsimtarit)
18. Analizë e tekstit
19. Poezia: “Ne jemi” (ose sipas zgjedhjes të arsimtarit)
20. Analizë e poezisë; motivi, idea

21. Hartim me shkrim me temë, “ Ne krijojmë botë të lirë, të lumtur dhe pa lot”
22. Teksti: “Letra e parë” (ose sipas zgjedhjes të arsimtarit)
23. Poezia: “Kurbet” (ose sipas zgjedhjes të arsimtarit)
24. Përpunimi i lektyrës _____
25. Vazhdimi i lektyrës...
26. Novelëza:“Luli i vocër”
27. Analiza e përmbajtjes sipas radhitjes së ngjarjeve
28. Lexim i tekstit: “Në bibliotekë” (ose sipas zgjedhjes të arsimtarit)
29. Bisedë rreth tekstitfaqe
30. Lexim në role: “Halili dhe Hajria”
31. Dramatizim i fragmentit në klasë
32. Zhv.Poezia: “Në liqenin e Ohrit” (ose sipas zgjedhjes të arsimtarit)
33. Bisedë: Tema dhe idea e poezisë
34. Lexim i tekstit: “Në Manastir” (ose sipas zgjedhjes të arsimtarit)
35. Zhv.teksti: “Dëllinja e Skënderbeut”
36. Analizë e tekstit
37. Përpunimi i lektyrës _____
38. Vazhdimi i lektyrës...
39. Teksti: “Në kurs të gjuhës” (ose sipas zgjedhjes të arsimtarit)
40. Teksti: “Sa është ora xhaxha” (ose sipas zgjedhjes të arsimtarit)
- 41.lexim Teksti: “Sa është ora xhaxha”
42. Të lexojmë: “Këndezi,pula apo veza “(ose sipas zgjedhjes të arsimtarit)
43. Lexim i tekstit : “Libri mbi princin e lumtur” (ose sipas zgjedhjes të arsimtarit)
44. Ushtrime leximi, rrjedhshëm dhe sipas intonacionit, ritmit dhe shenjave të pikësimit
45. Poezia: “Imam efendiu” (ose sipas zgjedhjes të arsimtarit)
46. Bisedë rreth poezisë, recitim...
47. Zhv. Fabula ”Gjinkalla dhe miz’ e dheut” “(ose sipas zgjedhjes të arsimtarit)
48. Gjëgjëzat
49. Zhv.Poezia “O sa bukur o sa mirë”. “(ose sipas zgjedhjes të arsimtarit)
50. Fjalë të urta
51. Zhv.Poezi humoristike ”Pasuria më e çmuar” “(ose sipas zgjedhjes të arsimtarit)
52. Të dallojmë legjendat , lexojmë:”Muji dhe Zanat”
53. Përpunimi i lektyrës: _____

54. Lexim i tekstit “Armiku i vjetër,ujku delengrënës”“(ose sipas zgjedhjes të arsimtarit)
55. Të dallojë elementet e poezisë (strofa, vargu, rima) te poezia “Mëngjesi”
56. Ushtrime për të zbatuar tablonë poetike, ritmin dhe rimën
57. Zhv.Teksti “Pal Golemi e Nik Peta “ (poemë)
58. Lexim teksti nga revista ose tekst nga E-përmbajtjet (E-libra) – Kloun i pikëlluar“ (ose sipas zgjedhjes të arsimtarit)
59. Zhv.Teksti “Gabojnë prindërit”
60. Kontrollim njohurish-Testim
61. Përpunimi i lektyrës: _____
62. Lexim i tekstit: “Më fal kanarinë “
63. Zhv.:poezia “Nënë e madhe e kësaj bote”.
64. Zhv.”Njeriu mëson nga e bukura”
65. Zhv.i trgimit “Një letër dhe diçka tjetër “
66. Lexim i tekstit:”Mesazh në celularë
67. Propozim i librave për të lexuar gjatë pushimeve verore

4. FUSHA PROGRAMORE: TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIJA (30)

Përmbajtjet mësimore:

1. Bisedë rreth situates së krijuar dhe kushteve për mësim si pasojë e pandemisë
2. Tregimi i ngjarjeve të përjetuara gjatë pandemisë ;
3. Përshkrim në mënyrë të pavarur i; sendeve- personazheve- figurave
4. Të shprehurit me shkrim në mënyrë të pavarur të tregojë sipas fjalëve të dhëna rreth një teme të caktuar.
5. Të shkruajnë në mënyrë të pavarur sipas fjalëve të dhëna rreth një teme të caktuar.
6. Të shprehurit me shkrim në mënyrë të pavarur sipas fjalëve të dhëna rreth një teme të caktuar.
7. Përshkrim në mënyrë të pavarur i sendeve ose personazh të preferuar
8. Të shkruajmë letër
9. Hartimi i parë me shkrim, Tema ...
10. Pyetje- përgjigje , të kuptuarit e tregimit nëpërmjet pyetjeve.
11. Të shkruajmë: tema “Alfabeti ynë është i përjetshëm
12. Të shprehurit me gojë: “Përshkrim i personazhit-Skënderbeut”
13. Ritregojmë ngjarjen dhe e shkruajmë

14. Analiza ose Ese: "Toleranca"
15. Njoftim me shkrim për ngjarje
16. Ushtrime me shkrim: "Dëshirat e mia për Vitin e Ri"
17. Shkrimi i urimeve për Vitin e Ri
18. Përshkrimi I stinës së dimrit
19. Ritregim I një teksti fantastic- shkencor
20. Përshkrim në mënyrë të pavarur të një vendi turistik
21. Të shkruajmë vjershë për nënën (krijim I pavarur)
22. Ese në temën: "Mirëserdhe dallëndyshe" (krijime të pavarura)
23. Ritregim i tekstit të përpunuar duke e zgjeruar atë
- 24 Shkruajmë: Letër, urim, lutje, ftesë. FP..
25. Shkrimi i fjalëve dhe shprehjeve të bukura për shkollën dhe për stinën e pranverës
26. Hartimi i dytë shkrim -----
27. Ritregim i filmit të shikuar...
28. Hartimi I një tregimi sipas analogjisë
29. Përshkrimi i sendeve, dukurive, personazheve
30. Njoftim me shkrim për ngjarje

5. FUSHA PROGRAMORE: KULTURA E MEDIËS (10)

Përmbajtjet mësimore:

1. Kompjuteri , interneti dhe përdorimi i tij
2. Orët e incizuara –
3. Mësimi në distancë
4. Librat elektronik
5. Në bibliotekë : Huazimi dhe kthimi i librave
6. Vizitë në bibliotekën e qytetit
7. Lexim teksti nga revista
8. Bisedojmë : Përralla dhe filmi.
9. Flasim për filmin
10. Bisedë – Edhe unë shoh TV .

3.Udhëzime didaktike:

Pikënisje themelore për realizimin e Programit mësimor të shkurtuar nga lënda **Gjuhë shqipe** është Programi i rregullt mësimor (qëllimet konkrete, konceptet, veprimtaritë dhe metodat . Realizimi efikas i përmbajtjeve mësimore në këtë Program mësimor , veçanërisht për formimin e koncepteve nga ana e nxënësve varet nga zbatimi i integritit në mësim. , që do të thotë se gjatë planifikimit ditor /orëve nga lënda Gjuhë shqipe maksimalisht të shfrytëzohen mundësitë për integrim me lëndët tjera.

Fushat programore nga Programi i shkurtuar duhet të realizohen gjatë 159 ditëve , 5 orë në javë , duke u ndërlidhur dhe plotësuar me njëra-tjetrën, kurse fondi i përcaktuar i orëve sipas fushave shërben vetëm si orientim për mësimdhënësin. Nga fondi i përgjithshëm i orëve të parashikuara sipas fushave programore mund të bëhen shmangie të vogla në pajtim me të veçantat e mjedisit ku ndodhet shkolla dhe nevojat individuale të nxënësve. Po kështu, në kuadër të fondit të përgjithshëm të orëve (për 159 ditë) në fushat programore lejohen disa shmangie edhe sa i përket dëndurisë së objektivave, përmbajtjeve dhe veprimtarive konkrete. Numri i orëve mund të përshtatet me nevojat e situatës momentale: pandemia me gripin Covid 19 , mënyra e realizimit të mësimit (me prezencë fizike të nxënësve në shkollë ose mësim në distancë) , kushtet e shkollës së caktuar (mjedisit jetësor të nxënësve , statusi i tyre kulturor-shoqëror dhe arsimor, përgatitja paraprake e nxënësve, paisja e shkollës

me mjete për incizim dhe realizim të përmbajtjeve mësimore, furnizimi me internet e tjera specifika si që janë Platforma “Eduino”, “Edmodo” e tjera në përputhje me rekomandimet e BZHA.

Orët mësimore duhet të realizohen në kuadër të 30 minutave duke i respektuar rekomandimet për sa i përket objektivave, përmbajtjeve arsimore , koncepteve , veprimtarive dhe metodave nga Programi mësimor për klasën e tretë në arsimin fillor nëntëvjeçar.

4. Норматив за наставен кадар

Normativ për kuadrin mësimor

Скратената наставна програма по албански јазик за петто одделение ја реализира наставик согласно нормативот за наставен кадар даден во редовната наставна програма

Programin e shkurtuar nga lënda Gjuhë shqipe për klasën e pestë mundet ta realizojë mësimdhënësi sipas normativit për kuadër arsimor të dhënë në Programin për arsimin të rregullt .

Скратената наставна програма по наставниот предмет албански јазик за петто одделение на деветгодишното основно образование ја утврди

Арх. Бр. 12-8424/200
16.09.2020

Министер за образование и наука
Мила Царовска